



01/Nr. 3951/2020
Data: 10.07.2020

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e katërt -IV- e Kuvendit të Komunës, i mbajtur me datë 30.06.2020 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Menduh Vlasi (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Ambientit) Bashkim Sopa (Zyrtar për Informim). Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i gjendjes rreth Coronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.
3. Miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2021-2023.
4. Shqyrtimi i Informatës për sektorin e emergjencave.
5. Shqyrtimi i Informatës mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.
6. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- me drejtorin e Arsimit jemi dakorduar që ai me paraqitur një informatë rreth komisionit që e kanë zhvilluar takimet për shkollën e fshatit Seçishtë dhe Krivenik. Për pikat e rendit të punës hapi diskutimin.

Florim Shkreta thekson:- kam kërkuar disa përgjigje me shkrim për pyetjet të cilat i kam parashtruar por nuk më janë dërguar dhe nëse ka mundësi me ditë arsyen se pse nuk më janë dërguar.

Kryesuesi thekson:- jo zyrtarisht më kanë njoftuar që kemi dhënë përgjigjen dhe nuk japim përgjigje tjetër.

Florim Shkreta thekson:- unë kam kërkuar që të më jepen faturat dhe nëse ka diçka të keqe këtu është mirë me treguar. Kryetarit të komunës i kam kërkuar përgjigje me shkrim për çështje të mirënjohjeve të viti 2019.

Rufki Suma thekson:- të gjitha mirënjohjet që i kemi dhënë në vitin e kaluar i kemi dhënë për kategoritë e dalura nga lufta e UÇK-së. Sa i përket faturave në zyrën e prokurimit keni drejtë me parashtruar kërkesë dhe mundeni me i pa por nuk keni drejtë me marr dokument sepse ligji e parasheh në atë formë.

Florim Shkreta thekson:- përgjigjet me zor unë nuk mundem me ua nxjerrë por kjo nuk është e ndershme as e moralshme dhe nuk është mirë me pru punën që me shkuar në mënyra tjera

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për rendin e punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mefail Suma thekson:- Kur opozita është kundër, duhet të shënohet në procesverbal, ngase vendimi që merret nga pozita konsiderohet i njëanshëm, dhe nuk ka nevojë me u shënuar emrat në procesverbal, sepse dihet kush janë ata të opozitës .

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit njëzëri.

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Shqyrtimi i gjendjes rreth Coronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Rufki Suma thekson:- prej mbledhjes së kaluar deri më tani nuk kemi pasur asnjë rast por ka pasur rast që janë bërë teste por kanë dalur negativë. Mjekët tanë janë duke punuar në pikën kufitare. Lëvizjet e qytetarëve janë dukshëm më të mëdha dhe afër 5500 qytetarë hyjnë në Kosovë të cilët u matet temperatura. Kemi pasur donacion prej 20 pakove ushqimore nga “Kryqi i Kuq”.

Samire Curri thekson:- me lirim e masave ka filluar të rritet edhe numri i të infektuarve dhe fatmirësisht deri tani nuk kemi pasur raste të reja, mirëpo me hapjen e kufirit pritet që të kemi të infektuar probabiliteti do të jetë më i madh sepse kemi edhe familjarë andej . Falënderojë stafin e QKMF –së të cilët kanë qëndruar me orë të tëra në pikën kufitare .

Teuta Shkreta thekson:- sa i përket stafit i cili ka qëndruar në pikën kufitare kërkoj që kryetari i komunës ta ushtron autoritetin e vetë në institucionet përkatëse për me i kompensuar stafin për ditën e shtunë dhe të diel , për shkak se zona kufitare nuk i përket komunës së Hanit të Elezit por kufiri është shtetërorë. Duhet të merret vendim prej qeverisë për sepse kemi edhe prej komunave të tjera që kanë kujdestaruar.

Mefail Suma thekson:- kam dëgjuar prej personave të ndryshëm që nuk paguhen infermierët për punën të cilën e kryejnë atje dhe kushtet e punës i kanë shumë të vështira. Çdo punëtorë që punon 24 orë duhet të ketë mundësi për akomodim në atë kuptim që me pushuar pak. Ata të cilët e kryejnë ndërrim këtu 24 orë direkt shkojnë në pikën kufitare dhe nëse është ashtu mendoj që është e ndaluar sepse askush nuk mundet që pas 24 orëve me kryer punë të tjera. Sa është i aftë ai mjekë apo infermiere që është në kufij për me bërë matjen e temperaturës apo ndonjë shërbim tjetër kur është lodhur. Rast kam pas që kam shkuar me i bërë analizat dhe kanë potencuar që nuk bëhen dhe pas disa kohe kam shkuar përsëri dhe kanë potencuar që këto analiza nuk bëhen këtu. Ndërkohë kam dëgjuar se është pranuar një punëtoare por si doket pa përvojë pune. Pse ka nejtë bash në kohë të pandemisë kur qytetarët kanë pasur nevojë me i bërë analizat e personalisht në Ferizaj më është dashur me shkuar me i bërë analizat dhe krahas rrugës kam pasur problem edhe prej policisë se pse nuk i bënë analizat në Han të Elezit. Pse nuk caktohet për me i bërë analizat punëtori që ka punuar shumë kohë aty z.Lumni Berisha sepse Hani i Elezit ka pasur lëvdata se i bënë analizat më të mira.

Florim Shkreta thekson:-unë nuk besoj që si trevë kemi kaluar mirë sepse asnjë qytetarit nuk ju është bërë testi në qendër për pos shtatë qytetarëve që ju ka bërë me kërkesë të kompanisë “Sharrcem” ndërsa prej komunës asnjë qytetarë nuk është marr parasysh që me ju bërë analizat . Prej drejtorisë së shëndetësisë a do të ketë ndonjë numër të caktuar që të paktën me ju bërë teste sepse kohët e fundit është qel kufiri dhe është rreziku më i madh dhe ka qenë e nevojshme një paralajmërim përmes faqes së komunës që me pas masa më të përpikta për shkak se numri vetëm po rritet.

Sabrije Krasniqi thekson:- është diskutuar prej qeverisë që ka me pasur karantinim të disa vendeve dhe a keni biseduar me qeverinë për kufirin , a mendoni që duhet të mbyllet kufiri për shkak se Maqedonia ka shumë banorë që janë të infektuar dhe mund të vijnë në Han të Elezit e mund të rrezikohemi si banorë dhe me pasur përsëri karantinim të vendit tonë.

Rufki Suma thekson:-mjekët të cilët janë në kufij i kanë marr pagat e veta dhe pagat shtesë prej qeverisë dhe drejtoresha i ka përcjellë mëditjet për çdo të shtunë ose të diele për punëtorët e QKMF-së së Hanit të Elezit. Sa i përket kushteve ende e dimë që nuk ka pasur kushte të mirë por është varur prej doganës apo prej policisë kufitare për objektin që ja kanë ofruar. Në fillim kushte ishin jo të mirë por ndërkohë në bashkëpunim me komunë i kanë dezinfektuar zyret dhe janë bërë kushtet më të mira për punë. Kontrollat tash nuk janë duke u bërë te terminali por vetëm te kufiri. Gjatë kohës së pandemisë ka qenë urdhëresë e ministrisë që me ndaluar disa shërbime përpos rasteve urgjente gjithçka ka qenë e ndaluar. Afër tri vite ka që nuk kemi laborant por kemi pasur me kontrata në vepër dhe në momentin që i a përfunduar kontrata në vepër është pranuar punëtori i ri dhe i bënë analizat por nuk bëhen analizat biokimike. Është marr vendim prej qeverisë që mos me u testuar as rastet e dyshimta as rastet e kontaktit por vetëm ata që kanë simptome. Në Han të Elezit përveç kompanisë “Sharrcem” që ka kërkuar disa punëtorëve me ua bërë testen kanë qenë edhe dy apo tri raste të tjera. Së fundmi një qytetarë e ka bërë testin për nevoja të veta për disa punë që i ka pasur në Maqedoni dhe ka dalur negativ. Çështja e kufirit është prej nivelit qendrorë në mes dy shteteve në mes të Maqedonisë dhe Kosovës dhe si komunë nuk kemi qasje. Është shumë e vërtetë që pas hapjes së kufirit Hani i Elezit është shumë më i rrezikuar për shkak të kontakteve që mund ti ketë me Maqedoninë por duhet të ruhem dhe ata të cilët nuk e ndiejnë veten mirë duhet të lajmërohen.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraprir sipas agjendës.

3. Miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2021-2023.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- për të ardhur deri te finalizimi i kornizës buxhetore jemi bazuar në dokumentet strategjike të komunës të cilat janë miratuar në kuvend më herët si plani zhvillimorë komunal, plani rregullativ urban , strategjia për zhvillim social ekonomik dhe jemi bazuar në kornizën ligjore si ligjin për financat e pushtetit lokal , ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë , ligjin për vetëqeverisje lokale dhe ligjin për kufijtë administrativë komunal. Në kornizën afat mesme buxhetore kemi parapira këto objektiva: Mbrojtja, përmirësimi i ambientit dhe infrastrukturës së Hanit të Elezit, Trajtimi i ndërtimeve pa leje ndërtimore dhe legalizimit i tyre në tërë territorin e Hanit të Elezit, Hartimi i PZHK-së dhe Hartës zonale të komunës së Hanit të Elezit, Mbledhja e të arkëtueshmeve (borxhet nga të hyrat e tatimit në pronë, nga ushtrimi i veprimtarive biznesore dhe nga shfrytëzimi i pronës publike), Përkrahja e bizneseve të reja dhe ekzistuese, Ngritja e shërbimeve dhe rritja e cilësisë në sektorin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, Ngritja e nivelit të cilësisë në arsim dhe edukim, Përkrahja e aktiviteteve të kulturës, rinisë dhe sportit, Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore, Funkcionalizimi i çerdhes së fëmijëve për parashkollor, Zhvillimi i turizmit rural, Zhvillimi dhe zgjerimi i aktiviteteve të sektorit të bujqësisë. Për vitin fiskal 2021 parashikohet një buxhet në lartësi prej 2,590,312 € apo një ulje prej 151,783 € apo për 5.54% më i vogël në raport me vitin 2020, kurse për vitin 2022 kemi një buxhet në lartësi prej 3,154,853 € apo një rritje prej 564,541 € ose 21.79 % në raport me vitin 2021, si dhe për vitin 2023 vlerësohet një buxhet prej 3,255,290 € apo një rritje prej 100,437 € apo për 3.18% më i madh në raport me vitin 2022. Është mbajtur diskutimi publik dhe sot është afati i fundit për me miratuar. Në material i keni të gjitha të dhënat e paraqitura dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Sabedin Hasallari thekson:- i keni radhitur dhjetë apo dymbëdhjetë prioritet të komunës por propozojë që objektiv numër një të jetë sigurimi i ujit të pijshëm për banorët e Hanit të Elezit.

Mehmet Ballazhi thekson:- këtu si objektivë nuk është diskutuar çështja e ujit. Ata të cilat i kam kërkuar disa herë në kuvend kanë qenë projekte konkrete që duhet të merren si prioritete por asnjë herë nuk janë marr parasysh. E fundit që kam kërkuar në KPF por nuk kam ndryshuar asgjë për shkak se të gjithë grupet parlamentare pajtohen se duhet të bëhen këto ndryshime dhe të procedohen këto projekte por nuk ka pasur asnjë ndryshim . Si objektivë shihet zhvillimi i turizmit lokal por nuk ka konkrete asgjë sepse në mënyrë formale figurojnë por nuk realizohen asnjë herë. Këtu ka mbetur me thënë që martoni këto sepse në këtë formë unë i kam paraparë si individ , mirëpo tatimet e qytetarëve janë që me ju kthyer përmes projekteve dhe asnjë projekt që ka dashur qytetari nuk ju ka kthyer përmes tatimeve. Asnjë ndryshim nuk është bërë në kërkesat që i kemi parashtruar në kuvend.

Mefail Suma thekson:- ministria kornizën e dërgon në bazë të kërkesave që i paraqet komuna caktohet edhe shuma e mjeteve financiare . Në këtë kornizë deri në vitin 2023 nuk pash diçka që do të ketë për investime kapitale . Edhe parafolësi potenco i për disa kërkesa që i ka parashtruar të cilat janë në interes të qytetarëve dhe unë kam kërkuar që të bëhet një ndërtesë e banimit por nuk është planifikuar te investimet kapitale. Në punëtori që ishim për planin zhvillimorë në Radikë është diskutuar për çështje të ujit se nga sigurohet për Hanin e Elezit por nuk ka asnjë lëvizje dhe asnjë mbështetje financiare . çdo herë është potencuar që komuna nuk e ka obligim por pyetjen të cilën e parashtrua se kush duhet ta siguron ujin qeveria apo komuna dhe z.Sami Stagova u përgjigj që komuna duhet të interesohet për ujin pra me rritur kapacitetin e ujit , mirëpo gati tre mandate po përfundojnë vetëm me mashtrim sot , nesër . Vendet se ku ka ujë janë të caktuara dhe të treguara dhe hulumtime bëni por nuk shihet diçka interesante në këtë kornizë afat mesme por vetëm paga , trajnimi i punëtorëve , mallra dhe shërbime , tjetër send nuk ka.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 10 për, grupi parlament i PDK ishte kundër, grupi parlamentar Nisma 1 ishte kundër. Prezent ishin 14 këshilltarë të kuvendit të komunë.

U MIRATUA KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2021-2023.

4. Shqyrtimi i informatës për sektorin e emergjencave.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Refet Kalisi thekson:-nga data 15.03.2020 kemi hyrë në pandemi dhe njësitë për emergjenca ka qenë i angazhuar dhe ka bërë një punë jashtëzakonisht të mirë . Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Mefail Suma thekson:- kuvendi i komunës i ka ndarë 10000 € për pandemi sa janë shpenzuar. Rrobat që i veshin kundra zjarrit a janë qind për qind që nuk djegën apo janë të thjeshta.

Sead Vila thekson:- tabelorin që e ka paraqitur është shumë konfuz dhe i thjeshtë e me shumë gabime teknike. Si asamblistë kur dal prej seancës nëse më pyet dikush për këtë pikë nuk kam ide se çka me i thënë . Unë mendoj që kjo informatë ka mundur të jetë më e shtjelluar dhe më e detajuar .

Samire Curri thekson:- në tabelën që është paraqitur shihet që nuk kemi numër të lënduarve dhe të vdekurve por uroj që muajt në vazhdim mos të kemi të lënduar dhe të vdekur .

Florim Shkreta thekson:- a do të rritet stafi i zjarrfikësve brenda këtyre viteve.

Refet Kalisi thekson:- tabelari është i thjeshtë por është i qartë . Për çështje të rritjes së stafit kemi parashtruar kërkesë në ministrinë përkatëse por nuk na kanë lejuar rritje. Nuk besoj që janë qind kundra zjarrit por ministria i ka furnizuar.

Shabi Rexhallari thekson:- janë shpenzuar 3000 € dhe në procedura janë 7000 €.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

5. Shqyrtimi i Informatës mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- në informatë janë të shënuara të gjitha detajet sa i përket çështjes së legalizimit dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Mehmet Ballazhi thekson:- si shkon proceduar për çështjen e shëndrrimit të pronës nga prona private në atë publike kjo më shumë ka të bëjë të çështjen e rrugëve

Nexhmedin Daci thekson:- nëse është në pyetje shtrimi i ndonjë rrugice pronarët japin një pëlqim dhe duhet që përfaqësuesi i komunës me pronarët privat me shkuar në gjykatë. Po ka raste që fillimisht pronari e ka dhënë pëlqimin dhe komuna e ka shtruar rrugën ndërsa procedurat do të kryhen në të ardhmen.

Florim Shkreta thekson:- sa do të paguhet për metër katrorë për shkak se ka pronarë që e kanë uzurpuar pronën dhe a do të jetë tarifa e njëjtë sikur për pronarin që është i parcelës.

Sead Vila thekson:- me pasur mundësi i kisha mbështetur të gjithë qytetarët që me bojkotuar në mënyrë që mos me paguar këtë formë të propozimit të kësaj ngarkese ekonomike tu e pas parasysh që për disa mund të doker e ulët dhe pak kosto por është dashur me dhënë kontribut drejtorët dhe deputet e jo vetëm nëpër sportele me i bartur dokumentet. Është dashur me menduar gjendjen e qytetarëve dhe jo vetëm gjendjen e vetë me menduar ministrat apo deputet apo kush do që ka kontribuar në këtë ligj . Nëse me një pronë private hiqen në mënyrë të pa autorizuar pikat kadastrale a obligohet pronari me i përcaktuar për mes gjeodetit apo komuna e bënë rivendosjen e pikave kadastrale.

Nexhmedin Daci thekson:- për legalizimin çmimi është unikë 1 € për metër katror në tërë Kosovën por me kusht ai që nuk ka problem me pronën , ndërsa ata të cilët kanë probleme me pronë kanë afat dy vjeçar dhe deri sa nuk e rregullon çështjen e pronës nuk mundet me legalizuar . Ata të cilët janë në prona të ujërave dhe të ekonomisë pyjore Qeveria e Kosovës ka me përpiluar një program të veçantë dhe me na i dërguar. z. Sead Vila mundet me ju dukur shtrenjtë por për mendimin tim nuk është shtrenjtë dhe nuk është mirë me bërë thirrje për me bojkotuar për shkak se nëse mendojmë me vepruar drejtë për me u pajisur me leje ndërtimore duhesh me pasur projekt ndërsa në legalizim nuk kërkohet projekt , raport gjeodezik për ndërtime mbi 450 metra katror kërkohet projekti i masave kundër zjarrit dhe hulumtimi gjeomekanik i pronës. Nëse aplikohet për leje ndërtimore ka kosto shumë më shtrenjtë se sa legalizimi. Sa i përket pikave duhet përmes kompanisë së licencuar me i rregulluar sepse gjeodetin vetëm për nevoja të komunës e kemi.

Kryesuesi thekson:- në ligj shënon një euro për metër katrorë ndërsa nuk potencohet që edhe një euro për raportin gjeodezikë . Unë kam menduar që me këtë ligj kanë me i dhënë fund legalizimeve por nuk kanë bërë asgjë dhe në realitet ky ligj nuk ka me u implementuar për shkak se ka kosto të madhe. Ju po i shikoni shtete në rajon në pandemi Anglia është duke dhënë kredi me kthim pas 2023, ndërsa në Kosovë në pandemi me detyruar me paguar 500 € apo 1000 € për me legalizuar nuk e shohë të arsyeshme.

Florim Shkreta thekson:- a mundet komuna me ja kryer raportin gjeodezik me gjeodetët të cilët i ka.

Nexhmedin Daci thekson:-nuk mundesh me regjistruar shtëpinë pa e pasur raportin gjeodezikë për shkak se raportin e kryen kompani të licencuara dhe ata kanë shpenzime të cilat i paguajnë shtetit sepse duhet të përdoren shërbimet satelitore.

Sead Vila thekson:- si qytetarë kam drejtë me u rreshtuar në çfarëdo formacioni, çdo pakënaqësie , çdo revoltë sepse është e drejtë e ime që ma garanton ligji . Nuk kam asgjë ndaj askujt por duke parë gjendjen socio ekonomike ata nuk kanë menduar për nevoja të qytetarëve.

Teuta Shkreta thekson:- a kanë filluar banorë me i legalizuar shtëpitë.

Nexhmedin Daci thekson:- po kanë filluar me legalizuar.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

6. Informata e Komisionit për gjendjen e shkollës në fshatin Seçishtë dhe Krivenik.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlashi thekson:- problemi i shkollë në fshatin Seçishtë dhe Krivenik është për shkak se numri i nxënësve është zvogëluar shumë . Në fshatin Krivenik dhe në fshatin Seçishtë kam pasur takime me prindërit me bërë një zgjidhje të përhershme e me ju krijuar kushte të mira nxënësve të cilat janë të barabarta me bashkëmoshatarët e tyre por nuk kam hasur në mirëkuptim deri sot . Numri i nxënësve edhe në fshatin Seçishtë ka rënë shumë e ligjërisht duhet të kombinohen klasat sepse një mësimdhënës punësohet me punuar me 21 nxënës , ndërsa në fshatin Seçishtë janë 38 nxënës nga klasa e parë deri në klasën e tetë. Duke i mbrojtur klasat në fshatin Seçishtë që mos me i kombinuar po detyrohemi me i grumbulluar nxënësit në Han të Elezit . në vitin e kaluar e paraqita këtë problem në kuvend dhe u potencua që duhet të shteren gjitha mundësitë në mënyrë që mos të kombinohen klasat në fshatin Seçishtë. Me datë 30.01. 2020 është mbajtur takimi i parë i këtij komisioni dhe në atë takim u dakorduar që të bisedohet me prindërit e nxënësve të cilët janë shpërngulur prej Seçishtë dhe kanë rënë në Lagje të Re në mënyrë që këto nxënës mos të vijnë në Han të Elezit por të kthehen në Seçishtë. Takimi i dytë ishte me datë 12.06.2020 dhe në këtë takim jemi dekoduar që të bisedojmë me prindërit e Lagjes së Re dhe pastaj me prindërit e fshatit Seçishtë . Drejtori aktual i shkollës ka biseduar me të gjithë prindërit të cilët i kanë fëmijët në klasë të parë në këtë vit dhe nuk ka mundur me has në mirëkuptim te asnjëri . Me datë 19.06.2020 kemi mbajtur takim në fshatin Seçishtë dhe në fshatin Krivenik dhe prindërit nuk janë pajtuar që me i kombinuar klasat. Zgjidhja e vetme është që ose duhet të bashkohen klasat ose me bërë transportimin e nxënësve sikur në Lagjen Hunel dhe në fshatin Laq. Unë mendoj që komisioni e ka kryer punën e vetë dhe për mua janë shter të gjitha mundësitë dhe duhet të veprohet në bazë të ligjit.

Florim Shkreta thekson:- mendoj që ka ende elemente që duhet me u shter për me u arsyetuar me banorët. Unë do ta diskutojë edhe një herë me kryesinë e fshatit këtë çështje. A ka ndonjë të dyshuar për parkun që u dëmtua te shkolla fillore “Ilaz Thaçi”

Hanumshahe Dibrani thekson:- gjashtë fëmijët të cilët janë regjistruar në Han të Elezit nuk është dashur me i pranuar por me ju rekomanduar që mi dërguar në fshatin Seçishtë.

Sead Vila thekson:- siç kam informata në disa komuna fëmijët i regjistrojnë në bazë të zonës kadastrale . Do të kishte qenë mirë që në të gjitha shkollat me pasur kushte të njëjta , cilësia me qenë e njëjtë, llogaridhënia dhe përgjegjësia për çdo mësimdhënës e jo me anashkaluar si fshatë. Çdo vendim që merret duhet të jetë për interes të fëmijëve dhe të familjarëve të tyre . Nëse vendoset që nxënësit në të ardhmen me i transportuar duhet të përmirësohen kushtet dhe aspekti i menaxhimit të kohës.

Sabrije Krasniqi thekson:- a mendoni me bërë ndonjë ndryshim të mësimdhënësve në ato shkolla që ndoshta në të ardhmen me pranuar prindërit që me i regjistruar fëmijët në ato shkolla. A keni të drejtë që regjistrimi kur të bëhet në vitin e ardhshëm që me ju rekomanduar që me u regjistruar në fshatin Seçishtë .

Menduh Vlashi thekson:-unë edhe më herët kam potencuar që pse me u pajisur me serra apo traktorë qytetari i Lagjes së Re kur fëmijët i dërgon me ndjek mësimin në Han të Elezit dhe këtë mund ta bëni në diskutim me banorët. Me ligj nuk kemi të drejtë që me ja kufizuar prindit se ku e regjistron fëmijën. Nxënësit që i transportojmë me pagesë të komunës janë komod por ka prind që te ura jeton dhe paguan dhe e shfrytëzojnë. Nuk është njëjtë kur ta regjistrojë fëmijën në klasë të parë dhe kam mundësi me zgjedhur sikur se nuk ke mundësi me zgjedhur.

7.Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlashi thekson:- vandalizmi që ka ndodh te shkolla fillore “Ilaz Thaçi” dhe në bazë të rrethanave që shihen e kanë bërë disa të ri që rrinë deri në orët e vona por polica i ka marr shënimet.

Hanumshahe Dibrani thekson:- zëvendës kryeministri z.Besnik Tahiri që ishte në vizitë a keni biseduar për çështjen e çerdhes.

Menduh Vlashi thekson:- në takim nuk kam qenë por informata kam që qeveria ka planifikuar me rrit numrin e punëtorëve.

Mefail Suma thekson:- para pandemisë e kam kërkuar kopjen e marrëveshjes që është bërë me Ministrin e Punëve të Brendshme për regjistrimin e automjeteve. Kam kërkuar kopjen e marrëveshjes që është bërë me kompaninë “Bifurkacioni” . Pse nuk bëhet regjistri i pasurisë së patundshme të komunës?

Sead Vila thekson:- kërkoj informacion me shkrim se nga kush është bërë përzgjedhja e pjesëmarrësve të cilët kanë marr pjesë në punëtorinë nga data 6 deri me 8 mars e cila është mbajtur në Mavrovë për planin zhvillimorë.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen e kuvendit të komunës.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 14:00

Procesmbajtësi

Avni Bushi





Kryesuesi i Kuvendit

MSc Qamush Brava

